



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 13.7, 15.1, 16.2, 19.2 dhe 33 të Ligjit për planifikimin hapësinor nr. 2003/14, të datës 3.7.2003, nenit 17 dhe 58 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr. 03/L-040, të dt. 20 shkurt 2008 dhe të nenit 16, par. 1, shkronja **b** dhe neni 32 të Statutit të Komunës së Prishtinës, të dt. 31.3.2008, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 12.5.2009, merr

V E N D I M
PËR FILLIMIN E HARTIMIT TË PLANIT RREGULLUES
“PRISHTINA E RE - PERENDIMI” NË PRISHTINË

Neni 1

Miratohet Vendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues “Prishtina e Re - Perëndimi” në Prishtinë.

Neni 2

Qëllimi i nxjerrjes së Planit rregullues, sipas këtij Vendimi, është rregullimi i hapësirës dhe urbanizimi, sipas destinimeve të planifikuara me Planin strategjik -zhvillimi urban i Prishtinës, i miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës nr. 01-031-1231/1, të dt. 2.7.2004, brenda kufijve të përshkruar në nenin 3 të këtij Vendimi.

Neni 3

Me Planin rregullues, nga neni 1 i këtij Vendimi, do të përpunohet pjesa e territorit të qytetit të Prishtinës, e emërtuar si “Prishtina e Re - Perëndimi”, e cila nga ana veriore përkufizohet me rr. “Fehmi Lladrovci”, vazhdon në drejtim të rr. “Muharrem Fejza”, përkufizohet me lagjen “Mati 1”, pastaj përshkon parcelat kadastrore nr: 2774, 2714, 2716, 2235, 2326, 539, 538, 500, 502, 504, 609, 610, 514, 637, 638, 639, 641, 1666, 644, 655, 657, 656, 747, 752, 778, 774, 773, 772, 768, 833/2, 836, 837, 843, 845, 862, 863, 864, 865, 879, 878, 881, 884, 885, 886, 894, 893, 891, 890, 1248, 1254/1, 1255/1, 1257/1, 1257/2, 1258/2, 1259/1, 1260, 1261, 1262, 1264, 1265, 1266, 1267, 1268, 1274, 1273, 229, 228, 227, 226, 225, 1279/1, 1286, 1287, 1288, 1289, 1292, 1293, 1294, 1295, 161, 164, 165, 258, 192, 191, 190, 189, 172, duke u kufizuar me territorin e lagjes “Kalabria” dhe me rrugën magjistrale Prishtinë-Shkup, me një sipërfaqe prej 420 ha.

Kufijtë e përshkruar të hapësirës nga par. 1 i këtij neni, janë të paraqitur në pjesën grafike, e cila është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

Neni 4

Bartëse e hartimit të planit, nga neni 1 i këtij Vendimi, është Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së mjedisit e Komunës së Prishtinës.

Për hartimin e Planit, nga neni 1 i këtij Vendimi, Komuna mund të ngarkojë agjenci dhe subjekte tjera, të specializuara dhe të certifikuar për hartimin e planeve hapësinore dhe urbane. Drejtoritë tjera të Komunës së Prishtinës janë të obliguara që të sigurojnë dhe t'i dërgojnë shënimet e kërkuara nga Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrës dhe Mbrojtjes së Mjedisit, për të cilat konsiderohet të jenë të nevojshme për hartimin e Planit rregullues sipas këtij Vendimi.

Neni 5

Mjetet financiare për hartimin e Planit rregullues, sipas këtij Vendimi, do të sigurohen nga buxheti i Komunës së Prishtinës.

Neni 6

Plani rregullues, sipas këtij Vendimi, do të miratohet me vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, si projektplan, në mënyrë që ai t'i nënshtrohet diskutimit publik para finalizimit dhe miratimit përfundimtar të tij.

Derisa të bëhet miratimi përfundimtar i planit rregullues për hapësirën e përshkruar në nenin 3 të këtij Vendimi, kërkesat për objektet me interes publik dhe lagje të organizuara do të zgjidhen përmes dhënies së pëlqimit në lokacion, me mundësinë e inkorporimit të lokacionit përkatës në Planin rregullues të këtij kompleksi.

Neni 7

Plani rregullues "Prishtina e Re - Perëndimi" do të jetë në harmoni të plotë dhe kooperativ me Planin rregullues "Prishtina e re- Qendra" dhe "Prishtina e re Lindje", të cilat gjatë projektimit do të mbikëqyren nga një ekip i ekspertëve të planifikimit.

Neni 8

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Drejtoria e Pronës e Komunës së Prishtinës, të cilat do të kryejnë veprime nga përgjegjësitë e caktuara për realizimin e këtij Vendimi.

Neni 9

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, pushon të vlejë Vendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues "Prishtina e Re" në Prishtinë 01 Nr. 35-581 dt. 27.12.2006

Neni 10

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01. Nr.35-853, më 12.5.2009

**KRYETARI I KOMUNES
Prof.dr. Isa Mustafa**